



Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU “GJAKOVA” SH.A. GJAKOVË



PLANI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE

Dhjetor, 2025

Plani i menaxhimit të emergjencave (PME) ,janë zhvilluar me mbështetjen e Projektit RCDN dhe programit Danube Learning Partnership (D-LeaP), në bashkëpunim të ngushtë me SHUKOS. Procesi i hartimit është udhëhequr mbi bazën e metodologjisë së standardizuar të përgatitur nga ekspertët vendor:

z. Afrim Lajci
znj. Burbuqe Nushi Latifi,

dhe ekspertët mbështetës

z. Albert Salltakaj znj. Lumnije Zeka.

PËRMBAJTJA:

Hyrje	5
1.1 Qëllimi	5
1.2. Kuadri Ligjor	6
2. Përkufizimet	7
3. Plani i Menaxhimit të krizave	10
3.1. Analiza e rreziqeve	10
3.2. Prioritetet e menaxhimit të Emergjencave	10
3.3. Struktura Organizative	11
3.5. Stafi i menaxhimit të krizës	12
3.6. Detyrat dhe përgjegjësitë	12
3.7. Infrastruktura e menaxhimit të Emergjencave	15
4. Hapat për Menaxhimin e krizave	16
5. Dokumentet mbështetëse për Menaxherin e krizes	24
5.1. Vendimi për Menaxhimin e krizes dhe masat	24
5.2. Konsideratat e para për M.K	25
5.3. Thirrja e stafit të menaxhimit të krizes	26
5.4. Ngritja e stafit për menaxhimin e krizes	27
6. Sistemi i Furnizimit me Ujë	27
6.1 Zona e shërbimit	27
6.2. Popullsia e shërbyer	28
6.3. Komponentët e sistemit	30
6.3.1. Liqeni dhe Penda në Gjakovë	30
6.3.2. Burimet dhe Impiantet e trajtimit të ujit	31
6.3.3. Sistemi i transmisionit	32
6.3.4. Rezervuarët dhe stacionet e pompimit	33
7. Vlerësimi i rrezikshmërisë	41
7.1. Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	41
7.2. Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së fatkeqësive	42
7.3. Efektet e fatkeqësisë	43
7.3.1. Mungesa e personelit	43
7.3.2. Kontaminimi i ujit	43
7.3.3. Dëmtimi i puseve dhe pompave	43
7.3.4. Prishja e gypave dhe komponentëve të gypsjesve	43
7.3.5. Dëmtimi i objekteve	43
7.3.6. Dëmtimi i baseneve në kuadër të impiantit të trajtimit	43
7.3.7. Ndërprerja e rrymës	44
7.3.8. Ndërprerja e komunikimit	44

7.3.9 Dëmtimi i sistemit të transportit	44
7.3.10. Dëmtimi i gypave të transmissio­nit në b­jeshkë	44
8. Komponentët kritike të sistemit.....	50
9. Masat paraprake të zvogëlimit/zbutjes së ndikimit	61
9.1 Mungesa e personelit	61
9.2 Masat zbutëse në burimin e ujit të papërpunuar dhe sistemin e transmissio­nit	61
9.3 Masat zbutëse në procesin e përpunimit të ujit	62
9.4 Rezervuarët.....	62
9.5 Masat zbutëse në rrejtin shpërndarës	62
9.6 Ndalimi i hyrjes në objektet e ujësjellësit për të gjithë personat e pa-autorizuar	62
10. Aktivizimi i planit.....	63
10.1 Procedurat e komunikimit	64
10.2 Zinxhiri komandues	64
10.3 Procedurat e njoftimit të palëve.....	66
11. Reagimi emergjent dhe rimëkëmbja	66
11.1 Hapi 1: Analizimi i llojit dhe ashpërsisë së incidentit.....	67
11.2 Hapi 2: Ofrimi i ndihmës emergjente për shpëtimin e jetëve	67
11.3 Hapi 3: Ndërmarrja e riparimeve emergjente bazuar në kërkesat prioritare	67
11.4 Hapi 4: Rimëkëmbja e sistemit.....	67
11.5 Hapi 5: Nxjerrja e mësimave dhe vlerësimi i planit	67
11.6 Hapi 6: Rishikimi i Planit sipas nevojës.....	67
11.7 Hapi 7: Trajnimi.....	68
Shtojca 1: Harta e Zonës së Shërbimit të KRU Gjakova me burime	69
Shtojca 2: Harta e Zonës së Shërbimit Komuna e Gjakovës - me burime	71
Shtojca 3: Harta e Zonës së Shërbimit Komuna Rahovec- me burime	72
Shtojca 4: Harta e Zonës së Shërbimit Komuna e Prizrenit – fshatrat që menaxhohen nga KRU Gjakova	73
Shtojca 5: Harta e objekteve vitale të sistemit në Reken e Keqe	74
Shtojca 6: Harta me valvulat kryesore në sistemin shpërndarës në KRU Gjakova.....	75
Shtojca 7: Harta sizmike e Kosovës.....	76
Shtojca 8: Harta e zonave vërsuese të Kosovës	77
Shtojca 9: Dokumentet mbështetëse për ekipin e asistuesve	80

FIGURAT

Figura 1: Hapat e Menaxhimit të krizave	5
Figura 2: Niveli i përshkallëzimit.....	9
Figura 3: Organizimi i ekipit të menaxhimit të krizës.....	13
Figura 4: Skema e sistemit të furnizimit me uji në KRU Gjakova	28
Figura 5: Skema e sistemit të transmisionit.....	30
Figura 6. Kursi i veprimit të menaxhimit të incidentit	75
Figura 8 – Vendndodhja e stacioneve të zjarrfikësve në Kosovë	76
Figura 9 – Vendndodhja e stacioneve policore në Kosovë	77

TABELAT

Tabela 1: Dokumentacioni i rekomanduar për Infrastrukturën e Menaxhimit të Emergjencave.....	15
Tabela 2. Pajisjet dhe burimet e rekomanduara për një infrastrukturë të menaxhimit të Emergjencave.....	15
Tabela 3. Popullësia dhe konsumatorët në zonën e shërbimit	27
Tabela 4. Të dhënat kryesore për pendën dhe akumulacionin e Liqenit të Radoniqit.....	31
Tabela 5: Përmbledhje e komponentëve të sistemeve të ujësjellësit të KRU Gjakova_	36
Tabela 6: Përmbledhje e fatkeqësive të mundshme dhe shkallës së rrezikshmërisë	41
Tabela 7: Matrica e efekteve të fatkeqësive	46
Tabela 8: Zinxhiri komandues Brenda Kompanisë	64
Tabela 9: Lista e agjencive dhe palëve të interesit për situata emergjente.....	67
Tabela 10: Klasifikimi i incidenteve	69

Shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
KRU	KRU Kompania Rajonale e Ujit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
PRE	Plani i Reagimit Emergjent
PML	Plani i Menaxhimit të Krizave
SHUKOS	Shoqata e Ujërave dhe kanalizimeve në Kosovë

Shënim: Ky dokument është hartuar bazuar në Manualin për Planin e Menaxhimit të Emergjencave të publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Ujëra (IWA) si dhe mbi platformën D-Leap. Qëllimi i metodologjisë ka qenë që të shërbejë si udhëzues për Kompanitë Rajonale të Ujit në Kosovë për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Emergjencave.

1. Hyrje

1.1 Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është që të përcaktohen veprimet që do të ndërmerren nga Kompania Rajonale e Ujit "Gjakova" SH.A, në rastet e incidenteve që rrezikojnë komponentët e sistemit të furnizimit me ujë dhe rrjedhimisht rrezikojnë cilësinë dhe sigurinë e furnizimit me ujë, duke u bazuar në vlerësimin e rrezikshmërisë që është pjesë përbërëse e këtij plani.


Vendosja e qasjes gjithëpërfshirëse Regjionale për menaxhimin e incidenteve ndaj të gjitha rreziqeve në spektrin e plotë të aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Plani i menaxhimit të Emergjencave (PME) përshkruan se si KRU Gjakova, do të reagojë ndaj një krize, duke përfshirë kush do të përfshihet dhe çfarë do të bëjë. Plani përpiqet të minimizojë dëmin dhe të rivendosë operacionet sa më shpejt të jetë e mundur,

Përfshin parashikimin e kërcënimeve, zhvillimin e strategjive për të minimizuar dëmin dhe zbatimin e këtyre strategjive kur ndodh një krizë.

- Të kesh një plan të menaxhimit të krizës është kritike sepse, pa të, njerëzit nën stres mund të marrin vendime të gabuara dhe mund të zgjasin ose përkeqësojnë pa dashje një krizë.
- Planifikimi ndihmon një kompani të përmbajë dhe zbusë efektet negative të një krize, e cila mund të përfshijë dëmtimin e reputacionit, humbjen e operacioneve dhe probleme ligjore ose rregullatore

Figura 1. Hapat e Menaxhimit të Emergjencave



1.2 Kuadri Ligjor

Disa prej ligjeve dhe akteve nënligjore për menaxhimin e emergjencave janë dhënë në vijim:

- Ligji Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit
Neni 48 përcakton obligimin e KRU-ve që të hartojnë planet e furnizimit me ujë në situata të emergjencave të cilat plane duhet të miratohen nga Autoriteti për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit-ARRU).
- Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
- Rregullore Nr. 08/2013 për Përmbytjen dhe Procedurat e Hartimit të Planeve të Reagimit Emergjent.
Neni 22, 23, dhe 24 përcakton përmbytjen e planeve të reagimit emergjent si dhe shtojcave tnevojshme që duhet t'i përmbajnë këto plane.
- Rregullore Nr. 28/2012 Për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
Neni 3 përcakton që vlerësimi i rrezikshmërisë është dokumenti bazë për hartimin e planeve, planeve operative dhe planeve të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, të cilin janë të obliguar ta hartojnë "...personat juridik, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me objektet e infrastrukturës kritike, përkatësisht objekteve të rëndësisë së veçantë..."
- Udhëzimi Administrativ nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum nga Njeriu.
Ky akt përcakton përgjegjësinë e autoriteti shëndetësor (d.m.th. Qendra e Ujit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike) për marrjen e vendimit për kufizimin apo ndalimit të përdorimit të ujit nga sistemi i ujësjellësit kur uji nuk i përmbush vlerat parametrike të përcaktuara me këtë Udhëzim.

Ky akt përcakton përgjegjësinë e autoriteti shëndetësor (d.m.th. Qendra e Ujit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike) për marrjen e vendimit për kufizimin apo ndalimit të përdorimit të ujit nga sistemi i ujësjellësit kur uji nuk i përmbush vlerat parametrike të përcaktuara me këtë Udhëzim.

2. Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimet si vijon:

Kriza: Një situatë ose ngjarje e rrezikshme, që nuk mund të menaxhohet efektivisht duke përdorur mjetet dhe strukturat e operimeve normale.

Ngjarje ose situatë që ka potencialin të ndikojë seriozisht tek kompania që mund të kërkojë struktura të tjera organizative dhe ndoshta më shumë sesa mjetet e zakonshme të operimit për t'iu përgjigjur një emergjence

Menaxhimi i Emergjencës: Lloj i posaçëm me kapacitete të veçanta organizativ të projektuar për të drejtuar Kompaninë gjatë një krize, jashtë organizimit të zakonshëm të punës.

Stafi i Menaxhimit të Emergjencës: Stafi i Menaxhimit të Emergjencës, i cili njihet edhe si skuadra e menaxhimit të krizës, është një njësi e posaçme organizative në kuadër të Kompanisë për Menaxhimin e Krizave.

Përbëhet nga:

Menaxheri Emergjencave dhe asistentët e tij më të afërt - stafi,

Stafi - funksionet e safit, secili prej tyre i ngarkuar me një fushë specifike të vlerësimit.

Ekipi i Ndhmës është pjesë e Stafit të Menaxhimit të Krizës dhe përbëhet nga disa anëtarë që e mbështesin Stafin në mënyrë të përgjithshme (d.m.th. me dokumentacion).

Stafi i menaxhimit të krizës është niveli më i lartë i vendimmarrës në nivel operativ.

'Emergjencë' - çdo ndodhi për të cilën nevojitet asistencë nga niveli i pushtetit lokal dhe qendror për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e asetëve dhe shëndetit publik ose për shmangien e rrezikut nga katastrofat në cilëndo pjesë të Republikës së Kosovës.

'Fatkeqësi' - një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërhyrjen e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta.

'Fatkeqësi natyrore' - janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortelet e borës, erërat e fuqishme, breshëri, borë me shi, acari, thatësia, zjarri fushor, shpërthimi i sëmundjeve infektive që rrezikojnë furnizimin me ujë.

'Fatkeqësi tjera' - janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë.

'Gatishmëri' - aktivitete efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident, të cilat fillojnë me një mori aktiviteteve përgatitore, të kryera në vijimësi shumë herët para çdo incidenti të mundshëm. Gatishmëria përfshinë një kombinim të integruar të vlerësimit, planifikimit, procedurave dhe protokolleve, trajnimeve dhe ushtrimeve, kualifikimit, licencimit dhe certifikimit të personelit, si dhe certifikimit, vlerësimit dhe inspektimit të pajisjeve.

'Incident' - një ndodhi natyrore ose e shkaktuar nga faktori njeri e cila kërkon një reagim emergjent për mbrojtjen e komponentëve të sistemit dhe për sigurimin e cilësisë së ujit në pjetim me

standardet. Në incidente mund të përfshihen: fatkeqësitë e mëdha, emergjencat, sulmet terroriste, zjarret urbane dhe malore, vërshimet, rrjedhjet e materieve të rrezikshme, aksidentet nukleare, aksidentet ajrore, tërmetet, shtrëngatat, fatkeqësitë e lidhura me luftën, emergjencat e shëndetit publik dhe ndodhit tjera që kërkojnë reagim emergjent.

‘Infrastruktura kritike’ – sisteme dhe asete (fizike apo virtuale) jetike për Republikën e Kosovës mosfunksionimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishin efekt të edëmshëm në siguri kombëtare, siguri ekonomike, shëndet apo siguri publike apo në kombinimin e cilës do prej tyre.

‘Kërcënim’ - ekspozimi real dhe i menjëhershëm i komponentëve të sistemit të furnizimit me ujë dhe cilësisë së ujit ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

‘Komandanti i Incidentit’ – person përgjegjës për të gjitha aktivitetet në incident, përfshirë zhvillimin e strategjive dhe taktikave si dhe porositjen dhe lirimimin e resurseve që ka përgjegjësinë dhe autoritetin e plotë për zhvillimin e operacioneve në incident dhe është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve në vendin e ngjarjes.

‘Masë parandaluese’ - çdo masë e ndërmarr për parandalimin e ndodhjes së fatkeqësisë ose për lehtësimin e pasojave të dëmshme të saj.

‘Materie e rrezikshme’ - çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve. Në materie të rrezikshme hyjnë helmet, kancerogjenet, kaustikët, oksidet dhe ngacmuesit (irrituesit), radioaktivët, infektuesit, eksplozuesit, materiet ndezëse ose materiet që shkaktojnë ndezje në kontakt me substanca tjera.

‘Paralajmërim’ - procedurat dhe aktivitetet për njoftimin e popullatës, komunitetit lokal, autoriteteve kombëtare për rrezikun real ose potencial nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër.

‘Parandalim’ - veprime të ndërmarra për shmangien e një incidenti apo ndërhyrje për ta penguar ndodhjen e tij. Parandalimi përfshin: (i) veprimet e ndërmarra për mbrojtjen e jetës dhe të mirave materiale, (ii) aplikimin e informacioneve të zakonshme dhe inteligjente në morinë e aktiviteteve të cilat mund të përfshijnë kundërmasat si operacionet e përmbajtjes; inspektimet e shtuara; operacionet e sigurisë dhe mbikëqyrjes së përmirësuar; hetimet për përcaktimin e natyrës dhe burimit të kërcënimit; mbikëqyrjen e shëndetit publik dhe bujqësor dhe proceset e testimit; imunizimet, izolimet apo karantinën; dhe sipas nevojës, operacionet e veçanta të zbatimit të ligjit të destinuara për pengimin, kapjen, ndalimin apo çrregullimin e aktiviteteve ilegale dhe kapjen e autorëve të mundshëm kriminal dhe dërgimin e tyre para organeve të drejtësisë.

‘Përfaqësues i agjencisë’ – person i caktuar nga agjencia qeveritare e nivelit lokal, regional apo qendror ose entiteti privat të cilit i është deleguar autoriteti për të marr vendime (duke ndjekur konsultimet e nevojshme me lidhshërinë), në emër të agjencisë pjesëmarrëse në aktivitetet e menaxhimit të incidentit.

‘Plani i Reagimit Emergjent’ - plan i hartuar dhe i mirëmbajtur për menaxhimin e rreziqeve të ndryshme të mundshme.

‘Plani i veprimit për menaxhimin e incidentit’ - një plan gojor apo i shkruar i cili përmban në vete objektivat e përgjithshme, të cilat reflektojnë strategjinë e përgjithshme për menaxhimin e incidentit. Mund të përfshijë përcaktimin e detyrave dhe resurseve operative. Gjithashtu mund të përfshijë shtojcat të cilat ofrojnë drejtim dhe informacione të rëndësishme për menaxhimin e incidentit, gjatë një apo më shumë periudhave operative.


‘Qendra Operative Emergjente’ - lokacion fizik në të cilin zhvillohet koordinimi i informacioneve dhe resurseve për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit. informacioneve dhe resurseve për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit.

‘Reagim Emergjent’ - aktivitetet të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit, plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale, ekonomike dhe politike të komunitetit të goditur.

‘Vlerësimi i rrezikut’ - analizat cilësore dhe sasiore të rrethanave natyrore dhe të tjera të lidhura me ndodhitë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, përfshirë vlerësimin e drejtimit të mundshëm të zhvillimit dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësia, nivelin e propozuar të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe propozimin për masat parandaluese dhe të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

‘Zbutja’ - aktivitete të destinuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve ndaj personave apo të mirave materiale apo për zvogëlimin e efekteve, pasojave aktuale ose të mundshme të një incidenti..

Figura 2. Niveli i Përshkallëzimit



3. Plani i Menaxhimit të Emergjencave

Plani i Menaxhimit të Emergjencave, është të përshkruaj rolet dhe koordinimin e punës për t'ju përgjigjur në kohë dhe me efikasitet në çdo rast krize apo emergjence.

Një krizë është një situatë e rëndë që mund të ketë pasoja për jetën, asetet si dhe për reputacionin e KRU-ve, dhe ku ngjarja mund të trajtohet në mënyrë më efikase duke përshtatur strukturën e KRU-Gjakova, dhe duke përdorur burimet e disponueshme në një mënyrë më të orientuar drejt qëllimit.

Edhe përkundër vlerësimit të rrezikshmërisë dhe ndërmarrjes së masave paraprake për parandalimin dhe zbutjen e efekteve të fatkeqësive, mund të ndodhin fatkeqësi të përmasave dhe shtrirjes që dëmtojnë komponentët e sistemit dhe rrjedhimisht kërcënojnë funksionimin normal të sistemit të furnizimit me ujë.

3.1 Analiza e Rreziqeve

Zhvillimi i një Plani të Menaxhimit të Emergjencave, duhet të fillojë me një vlerësim tek dobësitë, rreziqet dhe kërcënimet e mundshme me të cilat përballlet një Kompani Rajonale e Ujësjetës dhe vlerësimin e emergjencës duke përfshirë gatishmërinë në nivel korporativ, rajonal apo lokal.

Së paku, rreziqet e incidenteve që lindin nga:

- Mungesa e personelit
- Kontaminimi i ujit
- Dëmtimi i puseve dhe pompave
- Ndërprerja e rrymës
- Zjarri
- Rrjedhje e gypave (shpërthime)
- Mjedisi (moti (borë, vërshime, stuhi, akull), tërmete),
- Veprimet e palëve të treta (goditjet, dëmtimet e infrastrukturës, mjetet lëvizëse),
- Sulmet nga palët e treta (forcat madhore) (zjarrvënie, sabotim, kërcënime me bombë, dhunë ndaj klientëve dhe
- Punonjësit, sulmet kibernetike) etj.

3.2 Prioritetet në Menaxhimin e Emergjencave

Një nga çështjet më të rëndësishme të një Plani të Menaxhimit të Emergjencave, është çasja e KRU-së, për trajtimin e emergjencave. Konkretisht, çfarë konsideron KRU si prioritet kryesor gjatë një emergjence?

Këto prioritete mund të jenë:

- Shpëtimi i jetëve dhe parandalimi i lëndimeve të rënda
- Minimizimi i dëmeve në mjedis, pronë dhe asete
- Mbrojtja e reputacionit/imazhit të KRU-së
- Vazhdimësia e biznesit/kthimi në funksionimin normal

Proceset e rëndësishme ose thelbësore të KRU-së, duhet të mbështeten nga teknologji alternative, procese apo mjete të tjera.

Është e rëndësishme të theksohet se Menaxhimi i Emergjencave dhe Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit janë integrale për funksionimin normal të KRU-së.

3.3 Struktura Organizative

Kur zhvillohet një Plan i Menaxhimit të Emergjencave, duhet të jenë pikat/temat e mëposhtme adresuar dhe bazuar në vlerësimin e cenueshmerisë, rrezikut dhe kërcënimit. Nëse një Plan i Menaxhimit të Emergjencave është tashmë në vend, ai duhet të vlerësohet dhe të kontrollohet nëse mund të ketë tema shtesë.

Plani i Menaxhimit të Emergjencave, përbëhet nga përgjegjësit dhe drejtuesit të organizatave që duhet të ndjekin kur ka një fatkeqësi, ose një krizë që ka goditur organizatën. Pas paraqitjes së një krize, drejtues të përzgjedhur sipas Planit të Menaxhimit të Emergjencave, si ekip duhet të punojnë së bashku për të arritur kontrollin e krizës dhe për ta minimizuar atë. Një krizë/Emergjencë përgjithësisht kalon në tre faza:

E para i referohet si **Faza e Parakrizës** ku askush jashtë organizatës nuk është në dijeni të problem në rritje, nëse problemi nuk menaxhohet siç duhet dhe ai bëhet i njohur jashtë organizatës, problemi ka kaluar në **Fazën e Krizës Akute**. Pasi organizata identifikohet me krizën, **Faza e Pas krizës** fillon. Kur një krizë ka arritur në Fazën Akute ekipi i ME do të përdorë hapat e mëposhtëm për të frenuar krizën:

- Merrni përgjegjësinë shpejt.
- Përcaktoni faktet.
- Tregoni historinë tuaj.
- Rregulloni problemin.

3.4 Nivelet e Menaxhimit të Emergjencave

Është e rëndësishme të fillohet Menaxhimi i Emergjencave në kohën e duhur. Më mirë të filloni herët dhe të keni çdo gjë në vend, në rast se situata përkeqësohet. Për të arritur këtë, rekomandohet një sistem paralajmërimi ose alarmi. Ky kapitull tregon një shembull të një modeli me tre nivele që çon nga funksionimi normal në njohjen e një krize, pra aktivizimin e Planit të Menaxhimit të Emergjencave. Përcaktimi i nivelit të emergjencës duhet të jetë detyrë e Ekipit të Menaxhimit të Emergjencës, përveç nëse ndryshe thuhet qartë.

- a) Menaxhimi Strategjik ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për organizimin. Në rast krizash, ai është i autorizuar të aktivizojë Procesin e Menaxhimit të Emergjencave dhe të caktojë dhe të shkarkojë Menaxherin e Emergjencës. Menaxhimi Strategjik, në rast se nuk është vetë menaxheri i krizës, nuk e menaxhon drejtpërdrejt Stafin e Menaxhimit të

Emergjencave, por do të ketë raporte nga Menaxheri i Emergjencave i deleguar/caktuar dhe do t'i japë atij/asaj udhëzime.

- b) Menaxhimi Operacional përbëhet nga Menaxheri i Emergjencave dhe Stafi përkatës. Është detyrë e Menaxhimit Operacional të zgjidhë një situatë krize në mënyrën më të mirë të mundshme. Menaxhimi Operacional duhet t'i raportojë rregullisht Menaxhimit Strategjik, por duhet të ketë kontroll të plotë dhe të pakushtëzuar operacional mbi të gjithë organizatën për aq kohë sa Menaxhimi i Emergjencave është aktiv.
- c) Menaxhimi në terren përbëhet nga drejtuesit e zakonshëm të, që mund të angazhohen në Menaxhimin e Incidenteve apo në Menaxhimin e Emergjencave për aq kohë sa Menaxhimi i Emergjencës është aktiv. Ata marrin udhëzime nga Menaxhimi Operacional.

3.5 Stafi i Menaxhimit të Emergjencave: Struktura Organizative

Nëse një krizë që prek KRU-në, duhet të vendoset Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave në nivelin më të lartë të organizatës d.m.th. në nivel korporate. Mund të referohet si Ekipi Qendror i KRU-së për Menaxhimin e Emergjencave.

Detyrat kryesore të Ekipit Qendror të Menaxhimit të Emergjencave duhet të përfshijnë të paktën:

- Vlerësimi i situatës,
- Vendimi i nivelit të krizës,
- Aktivizimi i KRU-së ndaj krizës,
- Identifikimi i ekspertizës së kërkuar,
- Përcaktimi i masave të nevojshme,
- Koordinimi i vendimeve të kërkuara,
- Shpalljen dhe dokumentimin e vendimeve,
- Koordinimi me autoritetet (në nivel të lartë),
- Vendim për politikën e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Përbërja aktuale e Ekipes për menaxhimin e Emergjencave varet shumë nga madhësia e kompanisë dhe disponueshmëria e stafit drejtues të kualifikuar dhe me përvojë.

Menaxheri Emergjencave mundet që në çfarëdolloj kohe të caktojë anëtarë të rinj apo zëvendësues në Stafin e Menaxhimit të Emergjencave, si dhe të shkarkojë anëtarët e Stafit të Menaxhimit të Emergjencës.

3.6. Detyrat dhe përgjegjësitë

i. Menaxhimi Strategjik

Administrimi Strategjik vendos nëse duhet ta aktivizojë Menaxhimin e Emergjencave. Në atë rast, Menaxhimi Strategjik /Kryeshefi Ekzekutiv/ cakton një Menaxher të Emergjencave, i cili nga ana e vet cakton anëtarët e Stafit të Menaxhimit të Emergjencave.

Administrimi Strategjik komunikon me aktorët kryesorë, mund të komunikojë në emër të organizatës dhe mund të shkarkojë dhe të zëvendësojë Menaxherin e Emergjencës.

ii. **Menaxheri i Emergjencës**

Menaxheri i Emergjencës, është i vetmi menaxher operacional i KRU Gjakova, që nga momenti që ngrihet Menaxhimi i Emergjencës deri në momentin që deklarohet fundi i Menaxhimit të Emergjencës.

Pasi të emërohet nga Menaxhimi Strategjik, Menaxheri i Emergjencës, cakton dhe thërret Funksionet e Personelit, Ekipin e Ndhmës dhe ndoshta ekspertë të tjerë të brendshëm e të jashtëm në Stafin e Menaxhimit të Emergjencës.

Menaxheri Emergjencave, është vendimmarrësi më i lartë operacional i KRU Gjakova, dhe është i autorizuar t'i ngarkojë detyra/urdhra çdo punonjësi të KRU-së.

Menaxheri Emergjencave, është në vartësi të Menaxhimit Strategjik dhe raporton tek ai. Në të njëjtën kohë, Menaxheri Emergjencave, ka autoritetin të marrë çfarëdolloj vendimi në çfarëdolloj kohe pa konsultime paraprake dhe të ngarkojë detyra sipas rastit.

Funksionet ndahen në përgjegjësi si S2 (Intelegjenca), S3 (Operacional), dhe S5 (Komunikimi);

iii. **Funksioni i stafit 2 -Intelegjenca**

Funksioni 2 i stafit mbledh dhe vlerëson të gjithë informacionin ekzistues rreth faktorëve të jashtëm, veçorive dhe zhvillimeve të situatës. Ai bën një përmbledhje të gjendjes së jashtme si bazë për vendimet e menaxherit të Emergjencës.

Funksioni 2, i stafit është automatikisht përgjegjës për hartimin dhe përditësimin e një hartë të situatës.

iv. **Funksioni 3 i Stafit - Operacional**

Funksioni 3, i stafit mbledh dhe vlerëson të gjithë informacionin ekzistues rreth faktorëve të jashtëm, veçorive dhe zhvillimeve të situatës. Ai bën një përmbledhje të gjendjes së jashtme si bazë për vendimet e menaxherit të Emergjencës.

Funksioni 3 i stafit është ai i Zëvendësit të Menaxherit të Emergjencës, pozicion që merret automatikisht kur lindë nevoja.

v. **Funksioni 5 i stafit - Komunikimi**

Funksioni 5, i stafit mbledh dhe vlerëson të gjithë informacionin ekzistues rreth faktorëve të lidhur me komunikimin, veçorive dhe zhvillimeve të situatës. Ai bën një pasqyrë tërësore të kontekstit të komunikimit dhe të të gjithë audiencës së synuar. Përcakton objektivat e komunikimit dhe propozon mënyrat për arritjen e atyre objektivave, si bazë për vendimet e Menaxherit të Emergjencës.

vi. **Ekipi i Ndhmës**


Ekipi i Ndhmës është i ngarkuar me të gjithë dokumentimin formal, informimin e KRU-së.... nëse nuk ngarkohet me detyra të tjera, si dhe është në dispozicion për thirrjet telefonike dhe për aspektin IT të Menaxhimit të Emergjencës (pa përfshirë mediat sociale), me kujdesin për Stafin e Menaxhimit të Emergjencës, dhënien e udhëzimeve vizitorëve, si dhe me plotësimin e të gjitha nevojave të tjera të Stafit të Menaxhimit të Emergjencës. Ekipi i Ndhmës raporton vetëm tek Menaxheri i Emergjencës. Detyrat për funksionet e tjera të stafit mund të plotësohen me kërkesë të Menaxherit të Emergjencës.

Varësisht nga lloji i krizës duhet të integrohen funksione shtesë, p.sh.

Funksioni	Përshkrimi
Siguria	Ekspertiza e sigurisë, çështjet e mbrojtjes nga zjarri/puna
Financat	Vlerësimi i ndikimit financiar, kontakti me kompanitë/bankat e sigurimit, koordinimi i transaksioneve të nevojshme financiare
Njësitë tjera të KRU-së	Përfaqësuesit e njësive operative të prekura (p.sh. divizioni i burimeve ujore në këtë rast derdhje të mëdha të mallrave të rrezikshme)
Këshilltarë Brendshëm & Jashtëm	Varësisht nga lloji i krizës. Këto mund të jenë specialistë mjedisorë, inxhinierë, juristë, psikologë etj. Duhet të jenë parazgjedhur dhe përfshirë në listat e kontakteve.
IT	Përfaqësuesi i IT-së, vlerësimi i ndikimit të situatës në IT, pikë kontakti për të gjitha çështjet e IT-së

Kjo listë nuk është përfundimtare dhe varet shumë nga lloji i organizimit të KRU-së, poshtu mund të ndryshohet sipas nevojave të KRU-së.

Figura 3: Organizimi i Ekipit të Menaxhimit të Krizës



3.7. Infrastruktura e Menaxhimit të Emergjencave

Sugjerohet që çdo KRU, të ketë një infrastrukturë të caktuar për menaxhimin e Emergjencave në dispozicion.

Qëllimi është që të sigurojë:

- hapësirë, logjistikë,
- lidhjet e komunikimit dhe koordinimi i komunikimit,
- objektet e takimeve dhe informimit,
- mbledhjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për Ekipin e Menaxhimit të Emergjencave.

Idealisht, zyra duhet të jetë në objektin qendror të KRU-së, e çashme dhe me të gjitha materialet e nevojshme të cilat janë paraqitura mëposhtë.

Zyra duhet të jetë në objektin qendror të KRU-së, e çashme dhe me të gjitha materialet e nevojshme të cilat janë paraqitura mëposhtë.

Dokumentacioni i rekomanduar në dispozicion për të mbledhur për menaxhimin e situatës së krizës duhet të jetë në dispozicion në formë të shtypur dhe elektronike.

Tabela 1. Dokumentacioni i rekomanduar për Infrastrukturën e Menaxhimit të Emergjencave

Dokumentacioni	Patjetër	Duhet	Opsionale
Plani i Menaxhimit të Emergjencave	X		
Listat e komunikimit (PMK, KRU, palët e interesuara)	X		
Hartat (versionet dixhitale dhe fizike)	X		
Listat kontrolluese	X		
Listat e kontakteve	X		

Një nivel i caktuar i pajisjeve rekomandohet për një Infrastrukturë të Menaxhimit të Emergjencave.

Tabela 2. Pajisjet dhe burimet e rekomanduara për një infrastrukturë të menaxhimit të krizave

PAJISJET	Patjetër	Duhet	Opsionale
Hapësirë pune për stafin mbështetës/ Zyre	X		
Salla e mbledhjeve (për të gjithë stafin e MK)	X		
Aftësi shtesë takimesh (p.sh. për grupet e punës)		X	
PC me akses në internet	X		
Printera, flipchart, tabela të bardha, tabela shënjuese	X		
Laptop (qasje në rrjet, internet akses, kablllo, WiFi)		X	
Telefona për stafin	X		
Telefonat për anëtarët e MK Grupit	X		
Mundësia për konferenca telefonike	X		
Disponueshmëria e GSM (telefonat celularë)		X	

Mundësia për videokonferencë			X
Projektor (ekrane)	X		
Çasje në TV (lajmet e fundit)	X		
Mundësi të sigurta të komunikimit			X
Grirës dokumentesh	X		
Gjenerator për energji			X
Bateritë e celularëve dhe karikues	X		
Letër, lapsa, markera, etj	X		
Ushqim, Pije & Pushim	X		

Pajisjet dhe dokumentacioni duhet të kontrollohen, mirëmbahen dhe mbahen të përditësuara në intervale të rregullta.

Duhet të caktohet një interval kohor për kontrollimin e pajisjeve në mënyrë që në momentin e paraqitjes së krizave të jenë të përdorshme dhe të mos ketë ngecje.

4. Hapat për Menaxhimin e Emergjencave

4.1 Incidenti dhe Raportimi i Situatës

Është thelbësore që të organizohet një rrjedhë informacioni që lejon – pasi të zbulohet një incident – një vlerësim i shpejtë si:

Karakterit i asaj ngjarjeje

Çfarë ndodhi? Kush e bëri atë? Kur u zhvillua? Ku u zhvillua? Pse (Si) ndodhi?

Pasojat


A mund të çojë kjo (potencialisht) në një krizë?

Kjo vlen për të gjitha llojet e incidenteve, pavarësisht nëse ato kanë një siguri apo sfond tjetër, p.sh.

- incidentet ku lëndohen rëndë stafi i KRU-së
- incidente me dëmtime të rënda të infrastrukturës ose mjeteve lëvizëse,
- Incidente që çojnë në ndërprerje të proceseve të operimit (rënia e burimeve ujore si rezultat i prishjes së pompave, etj.),
- derdhja e mallrave të rrezikshme
- veprime kriminale (sabotim, vjedhje, shantazh, sulme kibernetike),
- Aktet e dhunës (kundër klientëve, punonjësve, në infrastrukturën e KRU-së etj.

Këto janë incidente të përsëritura që nuk janë shqetësim individualisht, por për publikun mund të servohen nga mediat si një shqetësim i madh.

Kjo listë nuk është e plotë dhe duhet të përshtatet me kërkesat specifike dhe llojin e operacionet sipas KRU-së.



4.2 Sinjalizimi

Para aktivizimit të Menaxhimit të Emergjencave, përgjegjësia për masat e nevojshme bie mbi stafin operacionale të secilës njësi të KRU-së dhe mbi drejtuesit e tyre.

Në rast incidentesh, çdo nivel i strukturës organizative vendos nëse e zgjidh apo jo vetë situatën e krijuar. Nëse vlerëson se situata është aq e rëndë saqë nuk mund të menaxhohet në nivelin aktual, atëherë sinjalizohet menjëherë niveli tjetër i autoritetit.

Drejtori Ekzekutiv merr vendim:

- **TË MOS** e fillojë Menaxhimin e Emergjencave (menaxhimin e situatës si incident apo si ngjarje e jashtëzakonshme) ose,
- Të fillojë Menaxhimin e Emergjencave, duke aktivizuar procesin e Menaxhimit të Emergjencave.

Ky vendim mund të bazohet në kriteret e paracaktuara dhe eksperiencat e mëparshme.

Drejtori Ekzekutiv emëron më pas Menaxherin e Emergjencave. Ky mund të jetë ose vetë Drejtori Ekzekutiv ose një tjetër drejtues i nivelit të lartë.

Rregulli i përgjithshëm për radhën e raportimit: Nëse duhet të informohet niveli më i lartë i menaxhimit dhe kjo nuk mund të realizohet brenda disa minutash, atëherë duhet të informohet një drejtues i nivelit të një shkalle më të lartë të menaxhimit.

Nëse nuk arrihet të kontaktohet askush nga drejtuesit e nivelit të lartë, atëherë autoriteti për menaxhimin e incidentit (jo për aktivizimin e Menaxhimit të Emergjencës!) mbetet tek niveli më i lartë i menaxhimit që informohet aktualisht.

4.3 Aktivizimi i Menaxhimit të Emergjencës

Stafi i Menaxhimit të Krizës mund të aktivizohet nga:

Lista e Funksioneve që mund të kenë autoritetin të aktivizojnë Menaxhimin e Emergjencës; kjo mund të jetë hierarkike, d.m.th. Vetëm Drejtori Ekzekutiv (CEO) dhe zëvendësit e tij sipas një radhe të caktuar ose mund të ketë autoritete paralele, d.m.th. një bord me shumë anëtare, ku secili mund të aktivizojë i vetëm Menaxhimin e Emergjencës, dhe të informojë direkt më pas punonjësit e tjerë të autorizuar).

Pas aktivizimit, caktohet Menaxheri Emergjencave nga (vendosni emrin e funksionit, normalisht duhet të jetë personi që aktivizon menaxhimin e Emergjencës).

SHËNIM: (Personi që aktivizon Menaxhimin e Emergjencës, mund caktohet edhe si menaxheri i Emergjencës.) Menaxheri i caktuar i Emergjencës bën një listë të personave që do të jenë pjesë e Stafit të Menaxhimit të Emergjencës dhe të Ekipit Ndihmës, dhe i thërret ata që të paraqiten nëpërmjet (kush do t'i bëjë telefonatat) në një vend dhe në një orë të caktuar.

Personat e thirrur duhet të takohen (ku) në orën e caktuar.

4.4 Konstituimi i Stafit të Menaxhimit të Emergjencës

Menjëherë pasi të kuptohet se KRU po përballlet me një krizë, drejtuesit duhet të aktivizojnë PME-në, dhe të kthejnë menaxhimin të krizës mbi të. Ky akt përcakton që drejtuesit e PME-së marrin nën kontroll autoritetin për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të menaxhuar krizën në mënyrë efektive dhe në kohë.

PME, duhet të aktivizohet shpejt në mënyrë që ata të mund të fillojnë të marrin përgjegjësi për situatën.

Kjo u lejon atyre të jenë proaktivë në menaxhimin e Emergjencës.

Anëtarët e PME-së, duhet të njoftohen dhe t'u tregohet se ku të raportojnë (d.m.th., Qendra e Komandës). Pas mbërritjes, situata e krizës duhet të jetë e vlerësuar dhe Stafi ME, duhet të përcaktojë veprimet që duhen bërë marrë. Ata gjithashtu duhet të sqarojnë se kush do ta menaxhojë Emergjencën, bazuar në "Llojin e Emergjencës".

Pasi të përcaktohet se cili anëtar i ME, do të menaxhojë Emergjencën, njerëzit brenda KRU-së, e dinë se kush është menaxheri. Menaxheri duhet të shkojë në vendin e Emergjencës, dhe të krijojë një vend komandimi aty, nëse është e mundur. Menaxheri Emergjencave, duhet të sigurojë që linjat e komunikimit hapet me njerëzit e duhur, pra me:

- Mediat
- Konsumatorët
- Aksionarët
- Punonjësit Zyrtar dhe
- Agjenci të ndryshme qeveritare etj.

Komunikimet e vazhdueshme me grupe specifike, si qeveria, aksionarët dhe konsumatorët do të trajtohen nga dikush tjetër mundet me qenë edhe Menaxheri i Emergjencës ose Zëdhënësi i Komunikimit të Emergjencës.

Menaxheri i caktuar i Emergjencës, është ai që e krijon zyrtarisht Stafin e Menaxhimit të Emergjencës, duke caktuar personat dhe duke u ngarkuar atyre detyrat/rolet përkatëse, si dhe anëtarët e Ekipit të ndihmës, shpall krijimin e Stafit të Menaxhimit të Emergjencës dhe urdhëron Ekipin e Ndihmës që të informojë të gjithë ndërmarrjen.

Që nga momenti i krijimit të Stafit të Menaxhimit të Emergjencës, dhe deri në fund të Menaxhimit të Emergjencës, çdo ngjarje, vendim/detyrë dhe arsyet e tyre, si dhe veprimet e Stafit të Menaxhimit të Emergjencës duhet të dokumentohen.

4.5 Takimi i parë informues

Menaxheri Emergjencave, bën një përmbledhje të parë të situatës për stafin e krijuar. Situata e përgjithshme, faktet, datat dhe orët e ngjarjeve të caktuara janë pjesë e kësaj përmbledhjeje, si dhe qëllimet dhe detyrat e stafit, si dhe koha dhe vendi se ku pritet raportimi i parë i situatës.

Ajo çka është më e rëndësishmja është se Menaxheri Emergjencave, duhet:

- Të përcaktojë një qëllim
- Të caktojë detyra të çarta për ekipin e Emergjencës,

Rrethana të rëndësishme që duhet të merren parasysh:

- Cilat janë afatet kohore të marrjes së vendimeve?
- Cilat janë masat që janë marrë apo që duhet të merren menjëherë?
- Çfarë informacioni nevojitet për marrjen e vendimeve?
- Cilat janë detyrat e Funksioneve të ndryshme të Stafit?
- Çështjet e konfidencialitetit
- Pikat e kontaktit për organizatat/kompanitë/ndërmarrjet e tjera
- Detyrat e Ekipit të Ndihmës

Ajo çka është më e rëndësishmja është se Funksionet e Stafit duhet

- Të kuptojnë si duhet detyrat që u ngarkohen
- Të zbatojnë detyrat e marra

4.6 Vlerësimi i parë i situatës

Pas përmbledhjes së parë, stafi fillon të vlerësojë situatën në fusha specifike që i është caktuar, secili funksion në fushën e vet dhe përgatitë një raport të parë të situatës.

Për përgatitjen e raporteve mbi situatën, duhet të merret parasysh tabela në pikën 3.5.

Pas identifikimit të “fakteve”, menaxheri i Emergjencës, së bashku me Zëdhënësi i komunikimit, duhet të përgatisë storien. Pavarësisht se sa e tmerrshme është ngjarja.

Le të mos ketë keqkuptime në përgatitjen e stories:

- Duhet të jetë e sigurtë,
- Duhet të jetë e arsyeshme

4.7 Ashpërsia e Emergjencës

Ashpërsia e një Emergjence, mund të ndryshojë shumë. Përcaktimi i kategorive të ashpërsisë do të ndihmojë që të përcaktojnë veprimet e duhura të reagimit. Të përcaktojnë një qëllim

- Të caktojë detyra të çarta për ekipin e Emergjencës

Rrethana të rëndësishme që duhet të merren parasysh:

- Cilat janë afatet kohore të marrjes së vendimeve?
- Cilat janë masat që janë marrë apo që duhet të merren menjëherë?
- Çfarë informacioni nevojitet për marrjen e vendimeve?
- Cilat janë detyrat e Funksioneve të ndryshme të Stafit?
- Çështjet e konfidencialitetit
- Pikat e kontaktit për organizatat/kompanitë/ndërmarrjet e tjera
- Detyrat e Ekipit të Ndihmës

Ajo çka është më e rëndësishmja është se Funksionet e Stafit duhet

- Të kuptojnë si duhet detyrat që u ngarkohen
- Të zbatojnë detyrat e marra

Niveli I:

Urgjencë rutinore: Sistemi përjeton një urgjencë rutinë, si p.sh. një linjë prishje ose ndërprerje të energjisë. Personeli i sistemit mund ta trajtojë problemin me një minimum intervenimi. Edhe pse është e rëndësishme për të filluar reagimin, ekipi i krizave duhet të qëndrojë i qetë dhe të punojë tërësisht përmes situatës. Urgjencat rutinë zakonisht mund të zgjidhen brenda 24 orëve.

Përshkrimi: KRU konsideron si më poshtë emergjenca të Nivelit I:

- Ndërprerjet e linjës së shpërndarjes.
- Ndërprerje të shkurtra të energjisë elektrike.
- Probleme të vogla mekanike në pompa.

Situata të tjera të vogla që nuk kanë gjasa të rrezikojnë shëndetin publik. Personi përgjegjës këshillon dhe drejton personeli i sistemit për të punuar për problemin. Ata zakonisht mund ta zgjidhin problemin brenda 24 orëve. Nëse ata përcaktojnë se do të duhen më shumë se 24 orë për të zgjidhur problemin dhe ruajtja ka të ngjarë të tërheqë poshtë një nivel të sigurt operimi, ata e ngrenë situatën në nivelin II.

Niveli II:

Krizë e vogël: KRU mund të ketë një furnizim me ndërprerje të vogël ose indikacione të kontaminimit të mundshëm. KRU mund të ketë nevojë të koordinohet dhe konsiderojë lëshimin e një këshillimi shëndetësor për konsumatorët. Këto lloj krizash (emergjencash) mund rrezikojnë shëndetin publik, ndaj është e rëndësishme që personeli i sistemit të jetë në gatishmëri dhe të fillojë një përgjigje të shpejtë. Urgjencat e vogla zakonisht mund të zgjidhen brenda 72 orëve.

Përshkrimi: KRU konsideron si emergjenca të Nivelit II:

- Ndërprerje e furnizimit, si p.sh. Ndërprerje e linjës kryesore të transmetimit, dështim i pompës dhe humbje e presionit.
- Rezervuari nuk është i mjaftueshëm përballuar ndërprerjet në furnizim.
- Një mostër e ujit me bakterien E. Coli ose të tjera.
- Një mostër fillestare e ndotësve kimikë primar.
- Një ndërprerje e klorit tek burimet e ujërave nëntokësore.
- Një akt i vogël vandalizmi

Niveli III:

Krizë (emergjencë) e rëndësishme: Sistemi ka probleme të rëndësishme mekanike ose problemet e kontaminimit dhe një ndërprerje e furnizimit me ujë është e pashmangshme. Është e rëndësishme dhe duhet lëshuar një këshillë shëndetësore për të mbrojtur shëndetin publik. Duhet të raportohet si emergjencë në nivel më të lartë sa më shpejt të jetë e mundur për të përcaktuar mënyrat më të mira të disponueshme për t'u mbrojtur shëndetin e konsumatorëve. Zgjidhja e një emergjence të rëndësishme mund të zgjasë më shumë se 72 orë.

Përshkrimi: KRU konsideron si vijon si nivel III :

- Një mostër e konfirmuar e një ndotësi primar kërkon shqyrtim të menjëhershëm
- Një humbje ose mosfunksionim i plotë i objekteve të trajtimit të burimit të ujit
- Një ndërprerje e madhe e linjës ose një dështim tjetër i sistemit që rezulton në mungesë uji ose kërkon sistemi të mbyllet.
- Vandalizëm ose kërcënim terrorist, si p.sh. Ndërhyrja ose dëmtimi i një objekti parësor.
- Rënie e menjëhershme e kapacitetit të burimit.

Niveli IV:

Emergjencë e Madhe: Sistemi ka përjetime të mëdha dëmtimi ose kontaminimi nga një fatkeqësi natyrore, aksident ose akt terrorist. Këto ngjarje kërkojnë veprim të menjëhershëm. Duhet të njoftohen forcat lokale të zbatimit të ligjit dhe urgjencën lokale shërbimet e menaxhimit menjëherë. Duhet të lëshohen menjëherë këshilla shëndetësore dhe të deklaroni një emergjencë e furnizimit me ujë për të mbrojtur shëndetin publik. Shpesh duhen disa ditë ose javë për të zgjidhni këto probleme dhe kthejeni sistemin në funksionimin normal.

Përshkrimi: KRU i konsideron ngjarjet e mëposhtme si të nivelit 4 ose madhor

- Tërmeti i madh, prek burimet, linjat, etj.
- Akti i terrorizmit që mund të ndotë sistemin uhor me biologjik ose kimik
- Vërshimet që depërtojnë në objektet dhe burimet e sistemit.
- Stuhi që dëmton ndjeshëm furnizimin me energji elektrike, objektet e sistemit të ujit, komunikimet ose SCADA sistemin, dhe korridoret e transportit të rëndësishëm për mirëmbajtjen e sistemit.

- Rrëshqitja e dheut ose zhvendosje tjetër e tokës që shkakton dështim të transmetimit ose humbje të ujit në pus.

4.8 Raporti i parë mbi situatën

Koha për raportin e parë të situatës vendoset nga Menaxheri Emergjencave, në takimin e parë informues. Në raportin e parë për situatën, Funksionet e Stafit bëjnë secili një prezantim të shkurtër të vlerësimit të tyre të situatës brenda kohës që u caktohet nga Menaxheri Emergjencave, dhe përcaktojnë një prognozë dhe masat që propozojnë të merren në bazë të vlerësimit të tyre. Prezantimet duhet të strukturohen sipas tabelës në faqen vijuese.

Funksionet e stafit duhet që t'i strukturojnë prezantimet e tyre në një mënyrë të caktuar në secilin raport të situatës, duke marrë parasysh edhe udhëzimet e tjera nga Menaxheri i Emergjencës. Përmbajtja e domosdoshme e raportit të situatës duhet të vizualizohet dhe të dokumentohet, duke përdorur për shembull një flip chart.

Shuma e raporteve të situatës ofron tablonë e plotë të situatës dhe i jep mundësi Menaxherit të Emergjencës, që të bëjë një vlerësim të plotë të situatës.

Raportet e situatës duhet të përgatiten sipas një strukture model që jepen në tabelën në faqen vijuese. Raportet mbi situatën duhet të pasohen me diskutime të fakteve të paraqitura dhe të masave të propozuara. Rezultatet e këtyre diskutimeve shërbejnë si bazë për vendimet që merr Menaxheri i Emergjencës:

- Çfarë duhet të bëhet?
- Kush është përgjegjës për zbatimin? Kush do t'i zbatojë masat?
- Në çfarë momenti duhet të zbatohen masat plotësisht?
- Cilat janë momentet/rezultatet e pjesshme për të cilat duhet të bëhet një raport progresi?
- Çfarë zhvillimesh kritike duhet të mbulojë raportimi?

Menaxheri Emergjencave, koordinon Stafin e Menaxhimit të Emergjencës si më poshtë:

- Çfarë duhet të vlerësojë stafi?
- Çfarë detyrash duhet t'i ngarkohen stafit?
- Kur duhet të paraqitet raporti i radhës për situatën?

4.9 Raportet e mëvonshme mbi situatën

Më pas, është detyrë e Funksioneve të Stafit që të mbajnë të përditësuar vlerësimin e situatës, ta shtjellojnë atë, të nxjerrin prognoza, si dhe të prezantojnë zgjidhjet dhe masat e propozuara. Prandaj, kontaktohen një sërë burimesh të brendshme dhe të jashtme. Për ta bërë këtë, stafi duhet të ketë gjithmonë parasysh udhëzimet e Menaxherit të Emergjencës, sa i përket konfidencialitetit. Informacionet e reja që vijnë duhet të kontrollohen gjithmonë nëse janë apo jo relevante. Informacionet shumë të rëndësishme që mund të ndryshojnë ndjeshëm të gjithë situatën duhet t'i raportohen menjëherë Menaxherit të Emergjencës. Të gjitha informacionet e tjera relevante duhet

të përfshihen në raportin e radhës për situatën ose t'i raportohen Menaxherit të Emergjencës me kërkesë të tij.

4.10 Vendimet nga Menaxheri i Emergjencës

Është kompetencë e Menaxherit të Emergjencës, që të marrë të gjitha vendimet për Menaxhimin e Emergjencës. Menaxheri Emergjencave, mund të delegojë marrjen e vendimeve në çfarëdo momenti, për shembull specifikat për zbatimin e masave të caktuara.

Menaxheri Emergjencave, mund të marrë vendimet e veta

- Menjëherë, pa konsultime paraprake
- Pas konsultimeve me një ose disa anëtarë të stafit ose drejtues të tij
- Pas një raportimi të plotë të situatës

4.11 Fundi i Menaxhimit të Emergjencës

Menaxhimi i Emergjencës mbyllet zyrtarisht me

- Vendim të Drejtorit Ekzekutiv (CEO)
- Vendim të Menaxherit të Emergjencës me miratimin e Drejtorit Ekzekutiv (CEO)
- Stafi i Menaxhimit të Emergjencës, lirohet nga detyra nga Menaxheri i Emergjencës.

Menaxheri Emergjencës, merr masat që të mblidhen, të dokumentohen dhe të ruhen të gjitha të dhënat e rëndësishme në lidhje me situatën e krizës. Më pas, duhet të bëhet një analizë e hollësishme e situatës së krizës dhe e hapave të ndërmarrë nga Menaxhimi i Emergjencës për identifikimin e hapësirave për përmirësim dhe të mësimave të nxjerra.

Kur urgjenca përfundon dhe KRU rifiton kontrollin, sistemi juaj duhet të përgatitet për t'u kthyer gjendje normale funksionimi. Ky mund të jetë një proces shumë i thjeshtë ose shumë kompleks, varësisht nga lloji dhe ashpërsia e urgjencës.

Duhet të merren parasysh shumë faktorë përpara se të ktheheni në funksionimin normal. Për shembull:

- A është riparuar sistemi juaj në mënyrë që të mund të plotësojë kërkesën dhe të funksionoj?
- A është bërë një inspektim të sigurisë dhe funksionimit të të gjithë sistemit, komponentët?
- A e keni shpëlarë, dezinfektuar dhe testuar me presion sistemin tuaj siç duhet?
- A e keni testuar ujin tuaj në mënyrë adekuate dhe a keni ndjekur rregullat e marrjes së mostrave?
- A i plotëson uji standardet?
- A ka staf adekuat për të operuar dhe menaxhuar sistemin?
- A keni zhvilluar mesazhet e duhura publike.

5. Dokumentet mbështetëse për Menaxherin e Emergjencës

5.1 Vendimi për Menaxhimin e Emergjencës dhe Masat e Menjëhershme

Menaxhimi i Emergjencës mund të aktivizohet nga:

Përballë një situatë që mund të kërkojë Menaxhimin e Emergjencës, kini parasysh pikat më poshtë:

- A ekziston / a mund të ekzistojë një rrezik ndaj integritetit fizik apo jetës së njerëzve?
- A ekziston / a mund të ekzistojnë pasoja të konsiderueshme për klientët?
- A ekziston / a mund të ekzistojnë pasoja të konsiderueshme për objektet / strukturat e ndryshme?
- Nëse po, sa do të zgjasin këto pasoja?
- A është organizata/kompania/ndërmarrja e përshtatshme sa duhet për menaxhimin e situatës?
- Cili do të ishte /skenari / rezultati më i keq i mundshëm?

Nëse keni një epror (d.m.th. një Drejtor Ekzekutiv - CEO) ose një koleg me të njëjtin pozicion në hierarki me CEO-n, informojeni / konsultohuni me të në lidhje me thirrjen e stafit të Menaxhimit të Emergjencës.

5.2 Konsideratat e para për Menaxherin e Emergjencës

Shqyrtoni se kur duhet të mblidhet stafi për Menaxhimin e Emergjencës, kush duhet të jetë pjesë e ekipit të Menaxhimit të Emergjencës, dhe nëse duhet apo jo të urdhëroni marrjen e masave të menjëhershme.

- A ka nevojë të menjëhershme për të marrë masa për mbrojtjen e integritetit fizik të njerëzve?
- A ka një nevojë të ngutshme për marrjen e masave për arsye të tjera (për mbrojtjen e konsumatorëve, objekteve, etj.)
- Çfarë burimesh të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme ekzistojnë?
- A është bërë incidenti ndërkohë objekt i vëmendjes së medias?
- A do të jetë ky incident objekt i vëmendjes së medias?

- A kam informacione të mjaftueshme për të marrë masa të menjëhershme?
- Kur duhet t'i marrin masat e para?
- Sa kohë duhet për përgatitjen e ngritjes së stafit për Menaxhimin e Emergjencës dhe për informimin e tij të parë?
- Cili është vendi më i përshtatshëm për t'u mbledhur stafi i Menaxhimit të Emergjencës?
